

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryetare, Mr.sc. Muhamet Rexha dhe Enver Peci, anëtarë, në çështjen juridike të paditësve-kundër të paditurve A.1 A.1, A.2 A.2, K. B. dhe M. (A.) S., të gjithë nga ..., të cilët i përfaqëson F. J., avokat nga ..., kundër të paditurit-kundër-paditësit R. K. nga ..., të cilin e përfaqëson H. K. avokat nga ..., për shkak të vërtetimit të pronësisë dhe dorëzimit të patundshmërisë, duke vendosur përkitazi me revizionin e të paditurit-kundër paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2459/2013 datë 24.12.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur më 04.10.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurit R. K. nga ..., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2459/2013 datë 24.12.2015.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.2459/2013 datë 24.12.2015 refuzohet si e pabazuar ankesa e të autorizuarit të paditurit-kundër paditësit dhe vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.1005/2009 datë 29.05.2013 me të cilin në pjesën I. të dispozitivit është aprovuar në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve kundër paditurve dhe se i padituri-kundër paditësi obligohet që paditësve-kundër-paditurve, t'ua kthejë-dorëzojë në posedim dhe shfrytëzim të lirë patundshmërinë e evidentuar si ngastra kadastrale nr..., ..., në vendin e quajtur "...", në sipërfaqe të përgjithshme prej 0.77,90 ha, e cila evidentohet në fletën poseduese nr.... ZKI padituri obligohet që nga kjo ngastër kadastrale t'i largojë të gjitha shtyllat dhe telat e metalit të vendosura në kjo parcelë dhe paditësve-kundër-paditurve t'ua dorëzojë këtë sipërfaqe në shfrytëzim të lirë dhe të papenguar dhe atë brenda 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë. Me pikën II. të

dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesa nga kundërpadia e paditurit-kundër paditësit me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se i padituri-kundër paditësi në bazë të shitblerjes dhe në bazë të mbajtjes është pronar i ngastrës kadastrale nr..., në vendin e quajtur "...", në sipërfaqe prej 0.77,90 ha, evidentuar në fletën poseduese nr..., ZK ..., dhe detyrohen kundër paditurit-paditësit që të pranojnë këtë të drejtë dhe kundër paditurit-paditësit t'i lejojnë që kjo patundshmëri të regjistrohet në regjistrin e paluajtshmërive në emër të tij, të gjitha këto brenda 15 ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi me kërcënim ekzekutimi. Me pikën III. të dispozitivit, mbetet në fuqi masa e sigurisë e dhënë me aktvendimin e kësaj gjykate C.nr.1005/2009 datë 04.10.2010. Me pikën IV të dispozitivit, obligohet i padituri-kundër paditësi që paditësve-kundër paditurve t'u kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën prej 885 €, të cilat duhet t'ua paguajë brenda 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë revizion me kohë ka paraqitur i padituri, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet e të dy gjykatave të prishen dhe çështja t'i kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në bazë të dispozitës së nenit 215 të LPK, ka gjetur se:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit-kundër paditurit, kanë kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia dhe të detyrohet i padituri-kundër paditësi që paditësve t'ua kthejë-dorëzojë në posedim dhe shfrytëzim të lirë patundshmërinë evidentuar si ngastër kadastrale nr..., në vendin e quajtur "...", në sipërfaqe të përgjithshme prej 0.77,90 ha, e sipas fletës poseduese nr..., ZK ..., dhe i padituri nga kjo ngastër kadastrale ti largojë të gjitha shtyllat dhe telat e metalit të vendosura dhe paditësve-kundër paditurve, t'ua dorëzojë këtë sipërfaqe në shfrytëzim të lirë dhe të papenguar.

Paditësit-kundër paditurit kanë kërkuar edhe masën e sigurisë të ndalimit të paditurit-kundër paditësit që të mos tjetërsojë ngastrën në fjalë si dhe të mos ndërmarrë kurrfarë veprimesh fizike që kanë të bëjnë me çfarëdo ndërrimi dhe t'i udhëzohet zyrës për vërtetim dhe legalizimin e

kontratave në Gjykatën Komunale në Prizren që të mos bëjë vërtetimin apo legalizimin e ndonjë kontrate mbi shitblerjen e patundshmërisë lëndore.

I padituri-kundër paditësi, me kundërpadi ka kërkuar që të vërtetohet se, në bazë të shitblerjes dhe të mbajtjes, është pronar i ngastrës së lartcekur dhe detyrimin e të paditurit kundër paditësit që t'ia pranojnë këtë të drejtë dhe të lejojnë që kjo patundshmëri të regjistrohet në regjistrin e patundshmërive në emër të tij.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se paditësit-kundër të paditurit janë pronar të ngastrës kadastrale nr..., sipas fletës poseduese nr..., në pajtim me nenin 36 të Ligjit për pronësi dhe të drejtat tjera sendore dhe nga kjo bazë ligjore të njëjtit kanë të drejtë të kërkojnë kthimin në posedim dhe shfrytëzim të pronës kontestuese në pajtim me dispozitën e nenit 93 të Ligjit mbi pronësi dhe të drejta tjera sendore.

Me pjesën II. të dispozitivit, ka refuzuar si të pabazuar kundërpadinë e të paditurit-kundër paditësit duke gjetur se ai këtë patundshmëri e ka shfrytëzuar me qesim dhe një shfrytëzim i tillë apriore nuk mundëson fitimin e të drejtës së pronësisë. Gjykata e shkallës së parë nuk ka pranuar si të bazuar parashtrimet e të paditurit-kundër paditësit se pronën kontestuese e posedon në bazë të punës së vlefshme juridike kontratë mbi shitblerje, nga fakti se, i padituri-kundër paditësi këtë pretendim nuk e ka argumentuar me fakte. Gjykata e shkallës së parë po ashtu ka vërtetuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore as për fitimin e të drejtës së pronësisë në favor të paditurit-kundër paditësit me parashkrim fitues, kjo për faktin se kjo ngastër deri në vitin 1996 ka qenë pronë e PIK "Progresit", e evidentuar si pronë shoqërore dhe sipas nenit 29 të LMTHJP në pronësi shoqërore nuk ka qenë e mundur të fitohet pronësia me parashkrim. Dispozitat e ndryshuara me datën 3.8.1996, të LMTHJP nuk gjen zbatim në rast konkret dhe në këtë rast të paditurit-kundër paditësit i mungon mirëbesimi dhe nuk ka kaluar afati kohor i paraparë me ligj, për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues, andaj ka refuzuar si të pabazuar kundër padinë e të paditurit-kundër paditësit.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën e ankimimit ka pranuar si të drejtë dhe të ligjshëm konstatimin faktik dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, andaj ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurit-kundër paditësit.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka refuzuar ankesën e të paditurit-kundër paditësit.

Në arsyetimin e aktgjykimit ka dhënë arsye të duhura faktike juridike, për faktet relevante për gjykim të drejtë të kësaj çështjeje juridike e që janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë. Faktet të cilat i ka vlerësuar gjykata e shkallës së dytë nuk vihen në pyetje në thëniet në revizion, provat tjera të analizuara më hollësisht nga gjykata e shkallës së dytë e materializojnë konstatimin e saj të fundit lidhur me zbatimin e së drejtës materiale me rastin e refuzimit të ankesës së paditurit-kundër paditësit. Aktgjykimi i goditur nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilat shkelje kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, e as me shkelje në të cilat revizioni pretendon.

Sipas mendimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së dytë drejt ka vlerësuar se paditësit-kundër paditurit janë pronar të ligjshëm të patundshmërisë evidentuar si ngastër kadastrale nr..., në f.p.nr..., ZK ..., Të drejtën e pronësisë në këtë ngastër e kanë fituar në bazë të dispozitës së nenit 36 të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore juridiko pronësore,(që ka qenë në fuqi në kohën kontestuese) në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Komunale në Prizren, C.nr.1058/94 datë 07.12.1995 dhe mbi këtë bazë me vendimin nr..., datë ..., kjo patundshmëri është bartur në libra kadastrale në emër të paditësve-kundër paditurve si bashkëpronarë. Pas parcelizimit të sipërfaqes së përgjithshme prej 1.23.90 ha, sipërfaqja kontestuese 0.77.90 ha, e ngastrës ..., tani evidentohet në emër të paditësve si bashkëpronarë. E drejta e paditësve si pronarë të kërkojnë paluajtshmërinë e vet nga jo pronari i cili këtë patundshmëri e mban në posedim pa bazë juridike, mbështetet në dispozitën e nenit 93 të Ligjit mbi pronat dhe të drejtat tjera sendore (punë të vlefshme juridike) që nevojitet për të fituar të drejtën e pronësisë. Prandaj, parashtrimet në revizion lidhur me zbatimin gabuar të së drejtës materiale kjo gjykatë i cilësoi si të pabazuara.

Po ashtu gjykata e shkallës së dytë drejt ka zbatuar të drejtën materiale kur ka refuzuar ankesën e të paditurit - kundër paditësit lidhur me kundërpadinë e parashtruar nga fakti se,i padituri-kundër paditësi nuk ka bazë të vlefshme juridike në patundshmërinë lëndore sipas të cilës kishte me pasur të drejtën e pronësisë dhe si pasojë e kësaj edhe të drejtën e posedimit.

Kontrata mbi marrjen në qesim nga KBI-ja “P.” të kësaj ngastre në shfrytëzim nga i padituri-kundër paditësi R. K., nuk paraqet bazë të vlefshme për fitimin e të drejtës së pronësisë në favor të tij. I padituri-kundër paditësi ka dështuar që të prezantojë fakte me qëllim të argumentimit të pretendimeve të tija lidhur me të drejtën e tij në pronën kontestuese në bazë të kontratës mbi shitblerje. Kjo Gjykatë po ashtu pranon si të drejtë dhe të ligjshëm përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për fitimin e drejtës së pronësisë me mbajtje në favor të paditurit-kundër paditësit, kjo për faktin se ngastra lëndore deri në vitin 1996 ka qenë në pronësi shoqërore dhe në bazë të dispozitës së nenit 29 të LTHMJP që ka qenë në fuqi, në pronësi shoqërore nuk ka mundur të fitohet e drejta e pronësisë në bazë të mbajtjes. Ndryshimet ligjore të bëra në këtë dispozitë duke shlyer këtë nen të datës 03.08.1996 nuk gjejnë zbatim në rastin konkret, pasi që ky ligj nuk ka pasur mundësinë e veprimit retroaktiv për llogaritjen e afatit të parashtrimit. Prandaj, kjo Gjykatë i cilëson si të papranueshme parashtrimet në revizion lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale me rastin e refuzimit të kundërpadisë së të paditurit-kundër paditësit.

Parashtrimet në revizion se aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është marrë me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore (182.2 pikan n) të LPK) për arsye se M. A., nuk është palën paditëse në procedurë nga fakti se në pikën II. të dispozitivit, të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë qëndron emri i M. S., kjo gjykatë parashtrimet e tilla i vlerësoi si të papranueshme dhe si të tilla i refuzoi, për faktin se nga përmbajtja e shkresave në lëndë rezulton se kemi të bëjmë me të njëjtin person pasi që M. S., mbiemrin e vajzërisë e ka A.

Parashtrimet në revizion se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar dispozitat e të drejtës materiale kur një pjesë të aktgjykimit e bazon në dispozitat e LTHMJP ndërsa pjesën tjetër e bazon në Ligjin e pronës dhe të drejtat sendore, këto parashtrime Gjykata i cilësoi si të papranueshme pasi që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me këto shkelje. Padia e paditësve –kundër paditurve(dt. 24.12.2009)lidhur me dorëzimin në posedim është vlerësuar në bazë të Ligjit për pronën dhe të drejtat tjera sendore, që ka qenë në fuqi në kohën e parashtrimit të padisë. Ndërsa, kërkesat nga kundërpadia lidhur me vërtetimin e të drejtës së pronësisë me mbajtje është vlerësuar në bazë të dispozitave LMTHJP që ka qenë në fuqi në kohën kur i padituri- kundër paditësi pretendon se ka fituar të drejtën e pronësisë me mbajtje.

Mbi bazë të asaj që u tha më sipër me zbatimin në nenin 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.112/2016 datë 04.10.2016

Kryetare e kolegjit,
Gyltene Sylejmani